

# DOKUMENTACIONI TEKNIK

Objekti :

Kalimi i perroit ne Celaj (Toç)

Pergatiti :

Ark. Jamir Tabaku

Memaliaj 2024

## RELACIONI TEKNIK

Objekti : “Kalimi i perroit ne Celaj (Toc)

Pershkrimi i gjendjes ekzistuese te rruges :

Nisur nga kerkesat e paraqitura ne bashki, u be verifikimi i situates ne terren, ne lidhje me kushtet teknike te vendkalimit, ku rruga ne Celaj nderpritet nga perroi.

Ne vijim te veprimeve verifikuese, u bene matjet ne kete vendkalim te shoqeruara me fotot perkatese, te cilat i jane bashkengjitur relacionit.

Konkretisht, situata ne kete vendkalim eshte shume e veshtire si per banoret e zones, ashtu edhe per automjetet, ne rast te reshjeve. Gjithashtu, duhet theksuar se rruga ne kete zone eshte e pashtuar.

Pershkrimi i projektit :

Duke u nisur nga matjet e kryera ne vend, si dhe pozicioni i rruges ne hyrje e dalje te perroit, u pa e arsyeshme te pergatitet nje projekt, i cili te siguroje realizimin e nje kalimi sa me normal te banoreve e automjeteve. Ne kete kuptim, duhet te plotesohen disa kushte teknike:

- Shmangia e kthesave te forta ne hyrje e dalje te perroit;
- Sigurimi i kalimit duke eliminuar pjerresite ne hyrje e dalje te perroit;
- Sigurimi i kalimit ne lartesine e brigjeve te perroit, per te shmangur permbytjen e kalimit ne rast te reshjeve intensive, si dhe per te mosnderhyre ne shpatet e perroit; etj.

Persa me siper, ne vijim te veprimeve. U mendua te realizohej nje projekt me konstruksion te perbere nga elemente b/a.

Konkretisht, ngjitur me brigjet e perroit, jane parashikuar dy bazamente mbeshtetese b/a, mbi te cilat do te realizohet kalimi me ane nje solete b/a.

Soleta b/a do te vazhdoje duke u bashkuar ne pozicion normal me rrugen, ne te dyja brigjet. Lartesia e kalimit do te jete rreth 3 metra (kjo eshte edhe lartesia e

brigjeve sot). Kalimi i automjeteve do te jete 3an je korsi rruge normale (3.5 metra). Per kalimin e kembesoreve jane parashikuar trotuare te shoqeruar me parmake. Parmaket do te jene rreth 90cm te larte. Ne hyrje e dalje te kalimit, ne te dyja anet e tij, jane parashikuar mure mbajtese b/a, per te ruajtur rrugen nga rreshqitja e dherave.







Pergatiti : ark. J. Tabaku

top. P. Hoxha

## SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti : “Kalimi i perroit ne Celaj (Toc)

Ne projekt parashikohet qe, soleta b/a te pergatitet detyrimisht me beton C-37/40 me cakell, ndersa elementet e tjere me konstrukcion b/a te pergatiten me beton C-20/25.

Gjate procesit te betonimit, te kryhet vibrimi ne te gjithe volumin e betonit. Per te gjitha betonimet te mbahen mostra si dhe te kryhen provat laboratorike.

Gjithashtu, pergatitja e elementeve b/a eshte parashikuar duke perdorur hekur betoni periodik ( $\varnothing \geq 12\text{mm}$ ).

Per te gjitha sasite e diametrat e hekurit te betonit, nga ana e subjektit zbatues te disponohen provat laboratorike.

Gjate procesit te lidhjes se hekurit te betonit, subjekti zbatues te siguroje lidhjen ne te gjitha kryqezimet.

Siperfaqja e te gjitha elementeve b/a, qe ndodhen ne prezencen e ujit, si dhe nentoke, te lyhen paraprakisht me emulsion me 2-duar bitum.

Pergatiti : ark. J. Tabaku

top. P. Hoxha